

Tiranë më 18/09/2023

STATUT

i

Shoqëri me Pergjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

"InTEN"

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "InTEN" udhëhiqet nga statuti i mëposhtëm

Emri

Neni 1.

- 1.1 Emri i Shoqërisë është "InTEN" (Shoqëria), ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "shpk", cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Ortaku i vetëm i Shoqërisë ("Ortaku") gjëzon përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë të përfaqësuar në kuota.
- 1.3 Shoqëria ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërите Tregtare"(Ligji i Shoqërive

Selia

Neni 2.

- 2.1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën adresën **Ruga e Dibrës, ndërtesa nr.113. Njësia Bashkiake nr.10, Tiranë**. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjeter të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 2.2. Selia e Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të vetëm.

Kohëzgjatja

Neni 3.

- 3.1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një një afat të pacaktuar.
- 3.2. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve me 75% kuotave të shoqërisë.

Objekti

Neni 4.

- 4.1 Shoqëria do të ketë si objekt kryesor: Farmaci. Tregti me shumice dhe pakice te artikujve farmaceutike. Tregtim medikamentesh, suplementesh, shtesash ushqimore, produkte kozmetike dhe medikal device online me pakice etj. Shoqeria do te mund te kryeje cdo aktivitet te ligjshem tregtar import, eksporti, tregtia me shumice e pakice te mallrave, pasurive të paluajtshme apo të luajtshme duke perfshire por pa u kufizuar vetem ne blerjen, shitjen, transferimin, ndertimin, nen-kontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhenin me qira, leasing e pasurive te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, dhenien e fitimin e cdo te drejtë apo privilegji ne lidhje me keto pasuri. Shoqeria mund te kryeje aktivitetit publikimi dhe reklamimi. Shoqeria mund te themeloje dhe/ose te behet bashkepjesetare në çfare dolloj ndermarrje në Shqiperi ose jashte shtetit, me te njëtin qellim apo të perafert qe funksionon në cdo forme ligjore. Import - eksport te artikujve farmaceutike, parafarmaceutike dhe artikujve te afert e te ngjashem me to. Tregti me shumice dhe pakice, import - eksport te artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve. Shitje online. Shoqeria gjithashtu mund te realizoje bashkpunime me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objektiv ose te ngjashem me ate te shoqerise si dhe bashkpunime me persona fizik. Veprimtari te ndryshme ne fushen tregtise sipas legjisacionit ne fuqi.
- 4.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në cdo kohë sic parashikohet në këtë Statut.

Kapitali Themeltar

Neni 5.

- 5.1. Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 10.000 (Dhjete mijë) Lekë, i përbërë nga 1 kuotë, me një vlerë nominale 10.000 (Dhjete mijë) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit.
- 5.2. Ortaku i vetëm themelues:
- Z. Dejvi Jazexhiu, i biri i Përparim-it, lindur më 13/12/1994, banues në , Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtës i kartës së identitetit me numër J41213073V, zotërues i një kuote të barabartë me vlerë nominale 100%.

Zvogëlimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar



Neni 6.

- 6.1. Ortaku i vetëm mund të vendosë për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit. Kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet më shumë se kufijtë e përcaktuar me ligj

Organet e Shoqërisë

Neni 7.

- 7.1. Organi me i lartë drejtues i kësaj Shoqërie tregëtare do të jetë ortaku i vetëm Dejvi Jazexhiu i cili do të jetë dhe administrator i kësaj shoqërie për një afat 5 Vjecar.
- 7.2. Ortaku i vetëm ka këto kompetenca:
- Ndryshimin e selisë së shoqërisë dhe emërtimin e saj
 - Vendos lidhur me pagat e punonjësve të shoqërisë
 - Ben ndryshimet e çfardoshme ne Statutin e Shoqërisë
 - Përfaqëson shoqerinë në marrdhënie me shtetin ose person të tjera juridik e fizik
 - Nëse administratori do të jetë i ndryshëm nga ortaku, emëron ose shkarkon atë sipas rastit.
 - Ushtron te gjithë kompetencat e tjera te parashikuara në ligjin Shqiptar, në këtë statut, akt themelimi apo akte të tjera juridike të mëvonshme, duke patur të drejtën që ti delegojë edhe personave të tjera kompetencat.
- 7.3. Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotave, transferohen tek cdo zotërues i ri për këto Kuota.
- 7.4. Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortakët mundet vetëm të mbajnë përgjegjësi brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zotërojnë; Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi që tejkalojnë investimin e tyre përkatësisht në kapitalin e Shoqërisë.
- 7.5. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortakëve të saj.

Transferimi i pjesëve të Kapitalit

Neni 8 .

- 8.1. Pjesët e kapitalit transferohen lirisht dhe mund të shiten edhe tek të tretë me vendim të ortakut të vetëm.
- 8.2. Cdo transferim i kuotave do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqërive dhe duhet të regjistrohet pranë Qëndres Kombëtare të Regjistrimit.

Administrimi dhe Perfaqësimi

Neni 9.

- 9.1 Shoqëria drejtohet dhe përfaqësohet nga një ose më shumë Administrator. Administratori (et) mund të jenë të cdo kombësie dhe nuk është e nevojshme të jenë rezidente në Shqipëri.
- 9.2 Administrator i Shoqërisë do të jetë: Z, Dejvi Jazexhiu i cili do e mbajë këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare me të drejtë ripërtëritje të këtij mandati të vendosur me vendim të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve
- 9.3 Kohëzgjatja e funksionit të Administratorit (eve) është për një periudhe prej 5 vjetesh, duke filluar që nga momenti kur kjo detyrë merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit).
- 9.4 Menjëherë pas pranimit të emërimit, Administratori(et) njojin në formë të shkruar se mardhënia e tyre me Shoqerinë ndërtohet mbi baza mirëbesimi; lidhur me këtë vendimi per heqjen e tyre nëpërmjet një vendimarrje të Ortakëve gjyket si arsy e ligjshme për shkarkimin e tyre, në perputhje me ligjet përkatëse.
- 9.5 Ortaku ka të drejtën të shkarkojë Administratorin (et) me shumicë të thjeshtë votash. Në rast shkarkimi të njërit dhe/ose të gjithë Administratorëve, Administratori(et) e rinj do të emrohen sipas procedurës së përshkruar në këtë statut.
- 9.6 Administratori (et) vepron në lidhje me cdo cështje të Shoqërisë që nuk është caktuar nën autoritetin e Ortakëve në perputhje me këtë Statut, dhe cdo apo të gjithë vendimeve të Ortakëve si dhe ligjeve të zbatueshme.
- 9.7 Për aq sa është e lejueshme dhe në perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kanë fuqi vepruese, Administratori(et) kanë të drejtën të marrin vendime në lidhje me detyrat e tyre pa qënë fizikisht present në Shqipëri ose në ambientet e Shoqërisë

Kompetencat dhe detyrimet

Neni 10

- 10.1 Kompetencat e Administratorit (eve) në kuadër të përfaqesimit të Shoqërisë përfshijnë:
 - (i) Thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.
 - (ii) Menaxhimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë nëpërmjet implementimit të politikave dhe planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
 - (iii) Përfaqësimin e Shoqërisë.
 - (iv) Kujdesin për mbajtjen në mënyrë të përshtatshme të dokumentave dhe librave kontabel të Shoqërisë.

- (v) Përgatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportit të ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve që i paraqiten për miratim Asamblesë së Përgjithshme.
- (vi) Krijimin e një sistemi paralajmerimi për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë.
- (vii) Kur është e nevojshme, kryejne regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e Shoqërisë pranë Qëndrës Kombëtarë të Biznesit dhe ose organeve të tjera, personalisht ose nëpërmjet të autorizuarve nga ai.
- (viii) Kryerjen e detyrave të tjera të caktuara në ligj.

10.2 Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojnë që zyrtaret, agjentet, të punësuarit, auditoret dhe këshilltaret e Shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesat e Shoqërisë.

Detyrimi i besnikërise dhe përgjegjësia

Neni 11

- 11.1 Përvec sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërise, sipas neneve 14,15,16,17 e 18 të Ligjit të Shoqërive, Administratori (et) detyrohen:
 - (i) të kryejnë detyrat e tyre e përcaktuara në ligj ose në këtë Statut në mirëbesim e ne interesin më të mirë të Shoqërisë në terësi.
 - (ii) të ushtrojnë kompetencat që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të percaktuara në këto dispozita;
 - (i) të vlerësojnë më përgjegjësi cështjet për të cilat merret vendim;
 - (ii) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshem, të interesave personale me ato të Shoqërisë;
 - (iii) të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikes 3 te nenit 13 të Ligjit të shoqërive;
 - (iv) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem
- 11.2 Administratori (ët) gjatë kryerjes së detyrave të tyre përgjigjen kundrejt shoqërisë për cdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprim apo mosveprim është kryer në mirëbesim.
- 11.3 Në rast të shkeljes së detyrës dhe standardeve profesionale, Administratori (et) është i detyruar të dëmshpérblejë Shoqërinë, për dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqërisë cdo fitim personal që ka realizuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të parregullta. Ai ka barrën e provës për të vërtetuar se kryen detyrat e tij në rregull dhe sipas standardeve. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administrator ata per gjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.

Administrimi Financiar i Shoqërisë

Eksperti Kontabel i Autorizuar

Neni 12.

- 12.1 Nëse kërkohet, Ortaku duhet të caktojnë ekspertin kontabël të autorizuar në numrin dhe kohëzgjatjen e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar. Ekspertet duhet të kryejne funksionet audituese në perputhje me legjislacionin shqiptar

Viti ekonomiko-financiar

Neni 13.

- 13.1 Viti ekonomiko-financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e 31-t të muajit Dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar nis në datën e themelimit të Shoqërisë.

Fitimi i Shoqërisë

Neni 14.

- 14.1 Fitimi i Shoqerise përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Ortaku i vetëm. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Ortaku i vetëm në përputhje me Statutin dhe me ligjet e zbatueshme.

Prishja e shoqërisë

Neni 15

- 15.1 Shoqeria mund të prishet në rrethanat e mëposhtme:
- (i) si pasojë e përfundimit të kohëzgjatjes për të cilin ishte themeluar;
 - (ii) me vendim të Ortakut të vetëm;
 - (iii) hapje e një procedure falimentimi;
 - (iv) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë.
 - (v) me vendim gjykate;
 - (vi) për arsyet e tjera të parashikuara nga Ortaku në cdo kohë.

Dispozita Përfundimtare

Neni 16 Ligji i zbatueshem

- 16.1 Shoqëria merr personalitet juridik në regjistrimin në regjistrin tregtar pranë Qkb
 16.2 Një kopje të këtij statuti dhe akt themelimi së bashku me vendimin depozitohen ne Qëndrën Kombetare të Biznesit

ORTAKU THEMELUES
DEJVI JAZEXHIU

